

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sisteme të përmirësuara, asistent IA dhe POS në telefon! Dev.al dhe Pago prezantojnë risitë - Shqiptarj a.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/arka-ia-dhe-pos-ne-telefon-prezantohen-risite-e-deval-pagesa-e-shitje-edhe-pa-internet-ndihmon-asistenti-virtual
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:21:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:19:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c0566595abfa43036bb81ce2a56c9076155c13b8bfcfb1911dfe45663783343b
TEKSTI	61221fbd7d6670072522e5a0caf0db6632abab34b7c374cd13b4435fab1f1c6a
PAMJA	6a19efa5683d5ac7357d3c8ceb5e8147037576672526f1f58bdef27e642cb21d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f62aca5b0d50176b786452488aff0ab5b8725757b9c6b6031987dfbadcb29232
E MËPARSHMJA	60654f5913259a52525b5be39a9a7986b781b3b6b596da4238938a6074c2363c
RRËNJA MERKLE	6df622084e2aa16fa426f4c8614ee06bfd4531cb8fc83f4931cef87e966f1ea1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f62aca5b0d50176b786452488aff0ab5b8725757b9c6b6031987dfbadcb29232>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Aksidenti i trafikut në Fushë Krujë, vdes 19-vjeçar! 2 të tjerë në gjendje të rëndë (VIDEO)



Sociale

Sisteme të përmirësuara, asistent IA dhe POS në telefon! Dev.al dhe Pago prezantojnë risitë

Një arkë që vazhdon të shesë edhe kur bie interneti. Një asistent virtual që përgjigjet për shitjet brenda sekondash dhe një telefon që kthehet në POS. Kompania dev.al dhe platforma e pagesave Pago kanë prezantuar sot risitë e tyre për bizneset shqiptare.



Redaksia

25 Shtator, 17:17 | Përditësimi: 25 Shtator, 18:20

f Share Tweet

A A

Në Pallatin e Kongreseve, në kuadër të panairit të teknologjisë [Future2Tech](#), [dev.al](#) dhe Pago paraqitën brenda një ore një listë të gjatë risish.

Versione të reja për katër sistemet që përdoren nga dyqanet, hotelet, zyrat e burimeve njerëzore dhe financat e kompanive. Një produkt krejt i ri për klinikat mjekësore. Një asistent virtual i mbështetur në inteligjencën artificiale. Dhe një grup zgjidhjesh të reja për pagesat.



"Prezantuar risitë e zgjidhjeve tona për biznesin, për menaxhimin, për faturimin, për kontabilitetin, për burimet njerëzore dhe për pagesat. Në situatën që gjendemi, biznesi gjithmonë e më shumë ka nevojë që të automatizojë procese dhe ajo që ne përpiqemi të bëjmë me zgjidhjet tona është pikërisht kjo. Pra ta ndjekim biznesin që nga fillimi deri në fund, pra nga marrja e produktit, nga zhvillimi i produktit, te shitja, te regjistrimi në kontabilitet, te marrja e pagesës, te krijimi i analizave që ndihmojnë në vendimmarrje. Mënyra më e mirë për ta bërë këtë është mënyra dixhitale", tha Igli Gjelshti.



LEXO EDHE:

Pago+, një produkt inovativ nga Rubicon, për sigurinë financiare të fëmijëve dhe të rinjve

Sistemet e kompanisë përdoren sot nga mbi 27.000 biznese në Shqipëri. Sistemi i faturimit vjen me një version që punon edhe pa lidhje interneti. Hotelet mund t'i shfaqin çmimet dhe dhomat e lira direkt në Google, pa komisionin e agjencive online. Ndërsa financave të biznesit tani u përgjigjet Devi, që merr pyetje me shkrim ose me zë dhe kthen përgjigje brenda sekondash.

Në fokus ishin edhe pagesat. Karta të reja me benefite premium, dërgesa të menjëhershme drejt kartave kudo në botë, dhe për bizneset, POS me fiskalizim të integruar si dhe SoftPOS, që mundëson pranimin e pagesave me kartë nga çdo telefon Android.

Dy zgjidhje që marrin rëndësi të veçantë para afatit ligjor të 31 dhjetorit, që detyron bizneset të pajisen me POS. Për shitjet online u prezantuan pagesat për dyqanet elektronike dhe pagesa me link, për ata që shesin nëpërmjet rrjeteve sociale. Sipas dev.al dhe Pago, fuqia e vërtetë e këtyre sistemeve, është fakti që janë të gjitha pjesë e së njëjtës zgjidhje- një ekosistem i vetëm, nga arka e biznesit deri te pagesa.

P.J/Shqiptarja.com

TAG: [pago.al](#) [dev.al](#) [Future2Tech](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komenta

Komenta





Sondazhi i ditës: Arrestimet e fundit nga SPAK, a janë provë e pavarësisë nga politika?

22 Shtator, 16:08

Po Jo Disi

Lajme të tjera



Dev.al feston 15-vjetorin – një dekadë e gjysmë përkushtim ndaj inovacionit dhe korrektësisë

9 Maj 2025, 17:27



Kompania dev.al rikthehet në Panairin "Future2Tech" si Gold Partner

9 Tetor 2024, 10:46



Edhe Shqipëria drejt përdorimit të kartave të kreditit, BSH: Mbështesim kompanitë Fintech, po avancojme drejt pagesave online si në gjithë BE-në



Eliza Gjediku

21 Mars 2024, 18:02



Dev.al zgjerohet në sektorin e shërbimeve financiare me blerjen e shumicës kontrolluese të Rubicon/Pago

7 Mars 2024, 16:30



Dev.al në Panairin Ndërkombëtar të Tiranës me 3 zgjidhje të reja

2 Dhjetor 2022, 10:06

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko